


**EC**  
MA NDRYSHË

# RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E ISTOGUT - 2025





# RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E ISTOGUT- 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,  
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

049 714 024

Maj, 2026

## Përmbajtja:

HYRJE.....	4
GJETJET E RAPORTIT.....	6
Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor.....	6
Korniza ligjore.....	6
Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.....	7
Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.....	7
Menaxhimi i Mbeturinave.....	9
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave.....	12
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike.....	13
Licencimi dhe lejet mjedisore.....	14
PËRFUNDIME.....	15
REKOMANDIMET.....	16
Për EC:.....	18

## HYRJE

Metodologjia për monitorimin mjedisor në nivel komunal është hartuar si instrument profesional për vlerësimin sistematik të gjendjes së mjedisit dhe funksionimit të mekanizmave institucionale në komunat e Kosovës. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, duke siguruar krahasueshmëri dhe koherencë ndërmjet komunave.

Kjo metodologji mbështetet në të dhëna primare të siguruar përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet komunale përgjegjëse për çështjet mjedisore për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe në të dhëna sekondare të nxjerra nga raporte zyrtare komunale, dokumente institucionale dhe burime të tjera relevante që kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e analizës.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.08/L-137 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina dhe Ligji nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e tij

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.08/L-065 për produktet biocide

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Metodologjia bazohet në analizën e këtyre komponentëve kryesorë të menaxhimit mjedisor:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Sistemet e monitorimit mjedisor
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Në këtë kuadër, analiza synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar elementet kryesore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe praktikën institucionale në nivel komunal.

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument identifikojnë çështjet kryesore dhe sfidat aktuale në sektorin e mjedisit, duke reflektuar gjendjen reale në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet komunale. Këto gjetje evidentojnë nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale, si dhe për forcimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Në funksion të kësaj analize, në pjesën përfundimtare janë paraqitur rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe avancimin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal, drejt një qasjeje më të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.

## GJETJET E RAPORTIT

### Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Istogut, organet institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë të themeluara dhe funksionojnë në kuadër të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis.

Kjo drejtori përfaqëson strukturën kryesore përgjegjëse për trajtimin e çështjeve mjedisore dhe përfshin sektorë dhe zyrtarë të angazhuar në menaxhimin e mjedisit. Brenda saj funksionon Sektori i Mjedisit, ku janë të angazhuar gjithsej 3 zyrtarë mjedisorë.

Në këtë kuadër, zyrtarët mjedisorë mbulojnë çështjet kryesore që lidhen me planifikimin dhe menaxhimin mjedisor në nivel komunal.

Organi komunal	Emri zyrtar	Fuqia punëtore
Drejtoria	Drejtorinë për Planifikimit Urban dhe Mjedis	/
Sektori	Sektori i Mjedisit	3
Zyrtar	Zyrtarë mjedisorë	3
Drejtoria	Drejtoria e Inspeksionit	/
Sektori	/	/
Zyrtar	Inspektor mjedisorë	1

Tabela 1 Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, numri i shërbyesve civil vlerësohet i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Gjithashtu, stafi disponon profilet e nevojshme profesionale për realizimin e përgjegjësive në këtë fushë.

Në aspektin e përgatitjes profesionale, stafi vlerësohet në nivel të mirë (4 nga 5), duke reflektuar një bazë të qëndrueshme njohurish për trajtimin e çështjeve mjedisore.

Sa i përket zhvillimit profesional, janë organizuar trajnime si për kornizën ligjore ashtu edhe për çështje mjedisore, megjithatë nuk është specifikuar numri i tyre.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, departamenti shfrytëzon udhëzues në fushën e menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë praktika si ndarja në burim dhe riciklimi.

Po ashtu, në kuadër të strukturës institucionale të komunës, mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit mjedisor realizohet përmes mekanizmave inspektues dhe raportimit përkatës në nivel komunal.

### **Korniza Ligjore**

Komuna e Istogut në planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbështetet në legjislacionin përkatës mjedisor, duke përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe Ligjin për Mbeturinat.

Korniza ligjore mjedisore vlerësohet si pjesërisht e konsoliduar, duke reflektuar ekzistencën e bazës ligjore, por edhe nevojën për përmirësime të mëtejme në zbatimin dhe funksionalizimin e saj.

Nuk janë identifikuar mangësi konkrete ligjore gjatë ushtrimit të përgjegjësive në nivel komunal.

Sa i përket njohurive të stafit lidhur me kornizën ligjore, ato vlerësohen në nivel të mirë (4 nga 5), çka tregon se ekziston një bazë solide njohurish për trajtimin e çështjeve mjedisore në nivel komunal.

### **Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**

Komuna e Istogut ka hartuar dokumente të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor që rrjedhin nga korniza ligjore në fuqi.

Dokumentet kryesore të identifikuara përfshijnë:

- Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM)
- Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM)
- Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave

Strategjitë dhe dokumentet mjedisore lokale janë të harmonizuara me strategjitë e nivelit qendror, duke reflektuar një përputhshmëri ndërmjet planifikimit lokal dhe politikave mjedisore në nivel qendror.

Sa i përket zhvillimit të projekteve mjedisore, komuna ka realizuar aktivitete që lidhen me përmirësimin e mjedisit dhe hapësirave publike, duke përfshirë:

- Eliminimin e mbeturinave nga hapësirat publike
- Fushata vetëdijesuese
- Vendosjen e tabelave informuese në hapësira publike

Në aspektin e masave për mbrojtjen e mjedisit, komuna ka ndërmarrë masa konkrete që përfshijnë:

Eliminimin e mbeturinave nga hapësirat publike

Mbjelljen e drunjve dekorues

Rehabilitimin e zonave të degraduara përmes mbjelljes së barit

Kjo qasje tregon se komponenti mjedisor është i integruar në dokumentet dhe aktivitetet e planifikimit komunal.

Sipas të dhënave të pyetësorit, gjatë vitit 2025 janë realizuar projekte dhe aktivitete që lidhen me menaxhimin e mbeturinave, përmirësimin e hapësirave publike dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor në komunitet.

Po ashtu, sipas raportit të Kryetarit për vitin 2025, janë realizuar edhe projekte konkrete infrastrukturore dhe mjedisore që kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, si:

- Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut (faza e dytë)
- Ndërtimi i parkut rekreativ në Banjë
- Rregullimi i trotuareve në zonat urbane (Banjë, Vrellë, Gurrakoc dhe Istog)

Gjithashtu, janë zhvilluar aktivitete që lidhen me rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjelljen e drunjve dekorativë, si dhe janë organizuar fushata vetëdijesuese në institucione shkollore për çështje mjedisore.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Burimi: Raporti i Kryetarit për vitin 2025

## **Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor**

Inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit realizohet në nivel komunal.

Sa i përket raportimit, hartohen raporte të inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore, duke përfshirë raportin vjetor të punës së Drejtorisë së Inspeksionit, si dhe realizohen inspektime të rregullta, të jashtëzakonshme, sipas ankesave dhe ri-inspektime, të shoqëruara me masa administrative.

Gjithashtu, hartohen raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore, përmes raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Inspeksionit.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike, duke treguar një nivel funksional të mbikëqyrjes në këtë aspekt.

Nga ana tjetër, nuk janë realizuar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese në mjedis.

Janë identifikuar raste të çrregullimeve mjedisore që lidhen me:

- Hedhjen e paautorizuar të mbeturinave
- Shkeljen e kushteve të lejeve mjedisore
- Dëmtimin e hapësirave natyrore

Ndërsa nuk janë raportuar raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara.

Në përgjithësi, aktivitetet inspektive në Komunën e Istogut përfshijnë kontrollin e zbatimit të legjislacionit mjedisor, trajtimin e ankesave dhe ndërmarrjen e masave administrative për parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë vitit 2025, në sektorin e mbrojtjes së mjedisit janë hartuar gjithsej 55 procesverbale, të ndara sipas fushave si në vijim:

- 24 procesverbale për menaxhimin e mbeturinave
- 4 procesverbale për ndotjen e ajrit
- 1 procesverbal për ndotjen e lumenjve
- 3 procesverbale për ndotjen akustike

- 21 procesverbale për ndotjen fekale
- 2 procesverbale për degradim mjedisor

Po ashtu, janë lëshuar 5 aktvendime dhe janë shqiptuar 11 gjoba mandatore<sup>2</sup>.

Gjatë kësaj periudhe janë raportuar pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës raste të ndotjes së lumenjve, ndotjes së ajrit dhe çështje të tjera mjedisore që janë në kompetencë të nivelit qendror.

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Istogut paraqet një komponent të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor, megjithatë analiza e këtij sektori ndikohet nga dallimet në metodologjinë e raportimit të të dhënave ndërmjet viteve.

Vlerësimi i gjendjes mbështetet në të dhënat e raportuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024.

Sipas të dhënave, numri i banorëve të shërbyer në Komunën e Istogut ka qenë 48,084 në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 është raportuar 39,916 banorë të përfshirë në shërbim, duke reflektuar një ulje prej 8,168 banorësh.<sup>3</sup>

Megjithatë, kjo rënie nuk lidhet me ndryshim në nivelin e mbulimit me shërbim, i cili mbetet konstant (100%) në të dy vitet, por kryesisht me dallimet në metodologjinë e raportimit dhe evidentimit të banorëve të shërbyer nga operatorët e mbeturinave ndërmjet viteve.

Sa i përket sasisë së mbeturinave, gjatë vitit 2023 janë grumbulluar gjithsej 11,569 ton mbeturina komunale, ndërsa në vitin 2024 kjo sasi ka rënë në 7,256 ton, duke reflektuar një ulje prej 4,313 ton.<sup>4</sup>

---

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

<sup>4</sup> Po aty

Ndërkohë, gjenerimi i mbeturinave për banor ka qenë 240.60 kg/banor/vit në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 ka rënë në 181.78 kg/banor/vit, që paraqet një ulje prej 58.82 kg/banor/vit.<sup>5</sup>

Treguesi	2023	2024	Ndryshimi
Numri i banorëve	48,084	39,916	-8,168
Sasia e mbeturinave (ton/vit)	11,569	7,256	-4,313
Sasia e mbeturinave (kg/vit)	11,569,000	7,256,000	-4,313,000
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/vit)	240.60	181.78	-58.82
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/ditë)	0.66	0.50	-0.16
Shkalla e mbulimit me shërbim (%)	100%	100%	0%

Tabela 2 Statistikat kryesore për menaxhimin e mbeturinave- Komuna Istog

***Shënim: Të dhënat për vitin 2024 i referohen banorëve të shërbyer dhe jo popullsisë totale.***

Të dhënat tregojnë një rënie të konsiderueshme të sasisë totale të mbeturinave të grumbulluara në Komunën e Istogut gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023. Njëkohësisht, është evidentuar edhe rënie e gjenerimit të mbeturinave për banor.

Megjithatë, kjo rënie duhet të interpretohet me kujdes, pasi ndikohet nga dallimet në metodologjinë e raportimit të popullsisë ndërmjet viteve, si dhe nga mundësia e ndryshimeve në nivelin e mbulimit me shërbime apo raportimit të të dhënave.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në avancimin e planifikimit dhe zhvillimit të sektorit të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal dhe ndërkomunal.

<sup>5</sup> Po aty

Në këtë drejtim, pas themelimit të komisionit komunal për hartimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2025–2030, në bashkëpunim me komunat e rajonit të Dukagjinit, është përfunduar hartimi i këtij plani dhe i njëjti është miratuar në Kuvendin Komunal.<sup>6</sup>

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe në bashkëpunim me organizatën GIZ dhe ekspertë të jashtëm, është në proces hartimi projekti i fizibilitetit për krijimin e një qendre ricikluese në Komunën e Istogut.<sup>7</sup>

### **Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave**

Komuna e Istogut nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe nuk janë raportuar stacione funksionale të monitorimit. Për rrjedhojë, nuk realizohet mbikëqyrje sistematike e cilësisë së ajrit.

Sa i përket komponentëve të tjerë mjedisorë:

- Komuna nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së dheut
- Nuk realizohet mbikëqyrje sistematike e cilësisë së dheut
- Komuna nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Nuk realizohet mbikëqyrje sistematike e cilësisë së ujit

Megjithatë, sipas të dhënave të pyetësorit, për disa komponentë raportohen forma të kufizuara të mbikëqyrjes, siç është monitorimi i cilësisë së ujit në baza ditore.

Në përgjithësi, nuk ekzistojnë sisteme të strukturuar për monitorimin e komponentëve kryesorë mjedisorë në nivel komunal.

Komuna e Istogut nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore.

---

<sup>6</sup> Burimi: Raporti i Kryetarit për vitin 2025

<sup>7</sup> Po aty

Megjithatë, departamenti posedon kapacitetet e nevojshme teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Kjo tregon se menaxhimi i të dhënave mjedisore në komunë mbështetet kryesisht në të dhëna administrative dhe aktivitete operative, ndërsa mungojnë sisteme të automatizuara dhe të standardizuara të monitorimit të vazhdueshëm.

### **Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vlerësohet në nivel të mirë (4 nga 5), duke reflektuar një nivel funksional bashkëpunimi institucional.

Në praktikë, ky bashkëpunim realizohet përmes organizimit të takimeve të përbashkëta dhe punëtorive të organizuara në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe organizata ndërkombëtare.

Sa i përket bashkëpunimit me nivelin qendror në hartimin e strategjive mjedisore, ai vlerësohet në nivel mesatar (3 nga 5), pa shembuj konkretë të raportuar.

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare vlerësohet në nivel të lartë (5 nga 5), duke reflektuar një angazhim të mirë në këtë drejtim. Sipas të dhënave të raportuara, bashkëpunimi është realizuar veçanërisht me organizata ndërkombëtare si GIZ, në lidhje me avancimin e kornizës ligjore dhe zbatimin e saj.

Në aspektin e pjesëmarrjes publike, komuna zhvillon procese të konsultimit publik gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Këto procese përfshijnë debate me qytetarët dhe konsultime gjatë hartimit të planeve komunale dhe ndërkomunale.

Niveli i pjesëmarrjes publike në këto procese vlerësohet si mesatar (3 nga 5), duke reflektuar një përfshirje të moderuar të publikut në proceset vendimmarrëse.

## **Licencimi dhe lejet mjedisore**

Komuna e Istogut lëshon leje mjedisore komunale në përputhje me kompetencat e nivelit lokal dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Në kuadër të këtyre kompetencave, gjatë vitit 2025 janë lëshuar gjithsej 24 leje mjedisore komunale, të cilat lidhen me aktivitetet që kanë ndikim në mjedis.

Kjo tregon se komuna ushtron funksionin e saj në procesin e licencimit mjedisor në nivel lokal, në përputhje me kornizën ligjore dhe procedurat administrative përkatëse.

## PËRFUNDIME

Bazuar në analizën e gjendjes së menaxhimit mjedisor në Komunën e Istogut, evidentohet se ekziston një strukturë institucionale funksionale dhe një bazë ligjore e konsoliduar që mundëson trajtimin e çështjeve mjedisore në nivel lokal. Kapacitetet njerëzore janë të kufizuara, por stafi vlerësohet me nivel të mirë profesional dhe është i angazhuar në mënyrë aktive në realizimin e përgjegjësive të tij.

Në aspektin e planifikimit dhe zbatimit të politikave mjedisore, komuna ka hartuar dokumente relevante dhe ka ndërmarrë aktivitete konkrete që lidhen me përmirësimin e hapësirave publike, menaxhimin e mbeturinave dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor. Realizimi i projekteve infrastrukturore dhe mjedisore tregon për një integrim të komponentit mjedisor në zhvillimin lokal.

Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me mungesën e sistemeve të strukturuar të monitorimit mjedisor dhe mungesën e sistemeve të automatizuara për menaxhimin e të dhënave. Kjo kufizon mundësinë për vlerësim të saktë dhe të vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit dhe për vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Në fushën e mbikëqyrjes inspektive, komuna ka treguar angazhim aktiv përmes realizimit të inspektimeve, hartimit të procesverbaleve dhe ndërmarrjes së masave administrative. Megjithatë, qasja mbetet kryesisht reaktive, e fokusuar në trajtimin e rasteve pas shfaqjes së problemeve.

Bashkëpunimi institucional dhe me organizatat joqeveritare paraqet një element pozitiv, ndërsa pjesëmarrja publike mbetet në nivel mesatar, duke reflektuar nevojën për rritje të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në përgjithësi, menaxhimi mjedisor në Komunën e Istogut karakterizohet nga një bazë funksionale institucionale dhe angazhim në nivel operativ, por kërkon avancim në aspektin e monitorimit, sistemit të të dhënave dhe qasjes strategjike afatgjatë.

## REKOMANDIME

1. Të zhvillohet dhe funksionalizohet një sistem i integruar për monitorimin e komponentëve kryesorë mjedisorë (ajri, dheu dhe uji), me qëllim sigurimin e të dhënave të vazhdueshme dhe të besueshme.
2. Të krijohet një sistem i strukturuar dhe i centralizuar për menaxhimin e të dhënave mjedisore, duke mundësuar përdorimin e tyre për vendimmarrje të bazuar në evidencë.
3. Të forcohen kapacitetet institucionale në sektorin e mjedisit përmes rritjes së numrit të zyrtarëve dhe avancimit të profilit profesional të stafit ekzistues.
4. Të organizohen trajnime të rregullta për stafin në fushën e kornizës ligjore dhe çështjeve mjedisore, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm profesional.
5. Të avancohen mekanizmat e mbikëqyrjes inspektive përmes kalimit nga qasja reaktive në qasje parandaluese, duke përfshirë hartimin e planeve të inspektimit të bazuara në analizë të riskut.
6. Të rritet bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, veçanërisht për trajtimin e çështjeve që tejkalojnë kompetencat lokale, si ndotja e ajrit dhe e ujërave.
7. Të fuqizohet bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë përmes përfshirjes aktive në iniciativa dhe projekte mjedisore.
8. Të përmirësohen mekanizmat e pjesëmarrjes publike, duke nxitur përfshirje më të gjerë të qytetarëve në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes.

9. Të vazhdohet me zhvillimin dhe implementimin e projekteve për përmirësimin e hapësirave publike dhe rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese, si pjesë e politikave për mbrojtjen e mjedisit.

## **Për EC:**

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

### **Deklarata e vizionit**

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

### **Deklarata e misionit**

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

**EC**  
MA NDRYSHE



[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)